

Mbi 46 000 viktima nga tërmetet në Turqi dhe Siri | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## NJOHJET, PENG I MARRËDHËNIEVE ME SERBINË



Njohja e fundit që mori Kosova ishte para dy vjetësh nga Izraeli. Para saj, për gati tre vjet, Kosova nuk u njoh nga asnjë vend. "Meqë në marrëdhëniet Kosovë - Serbi nuk ka ndryshuar asgjë tash e 15 vjet, shtetet që kanë qenë të

pavendosura [për pavarësinë e Kosovës] nuk kanë pasur asnjë arsye për të ndryshuar qëndrim", thotë Petr Cermak nga Shoqata për Çështje Ndërkombëtare e Çekisë. Një pjesë të fajit për këtë ai ua hedh edhe autoriteteve të

Kosovës që, siç thotë, nuk e zbatuan Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, konkretisht pjesën për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

## KURTI BISEDON ME SCHOLZIN PËR PROPOZIMIN EVROPIAN



## TAHIRI: ASOCIACIONI MUND TË ÇOJË NË NDRYSHIMIN E KUFIJVE NË BALLKAN



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## AKTUALE



MACRONI: DUA HUMBJEN E RUSISË NË LUFTË, POR JO SHKATËRRIMIN E SAJ F.2

MUSTAFA: SHBA-ja, GJERMANIA DHE FRANCA TA SQAROJNË A KANË KUNDËRSHTI ME KURTIN, I NDIHMUAN TË VIJË NË PUSHTET F.2

ZELENSKY ZOTOHET SE RUSIA DO TË PËRBALLET ME "PASOJA LIGJORE" PËR VEPRIMET NË UKRAINË F.2

## EKONOMI



NGRITJA E VAZHDUESHME E ÇMIMEVE TË KONSUMIT, KËRKOHET REFLEKTIM I QEVERISË F.7

RAFUNA: EKONOMIA E VENDIT, NËN HIJEN E ZHVILLIMEVE POLITIKE F.7

## SPORT



TREPÇA FITON KUPËN PËR MESHKUJ, BASHKIMI PËR FEMRA F.10

## Macroni: Dua humbjen e Ruisë në luftë, por jo shkatërrimin e saj

PARIS, 19 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron u shpreh se dëshiron humbjen e Ruisë ndaj Ukrainës, por jo kolapsin e saj. Në të njëjtën kohë ai paralajmëroi ata që "mbi të gjitha duan të shtypin Rusinë" se ky nuk do të jetë kurrë qëndrimi i vendit të tij. "Unë dua humbjen e Ruisë në Ukrainë dhe dua që Ukraina të jetë në gjendje të mbrohet, por jam i bindur se, në fund, kjo nuk do të bëhet me mjete ushtarake", tha Macroni në një intervistë që dha për mediet franceze. "Unë nuk besoj, siç bëjnë disa, që ne duhet ta shkatërojmë plotësisht Rusinë, ta sulmojmë atë në tokën e saj. Këta vëzhgues duan mbi të gjitha ta shtypin Rusinë. Ky nuk ishte dhe nuk do të jetë kurrë qëndrimi i Francës", shtoi ai. "Vëzhguesit" duket se janë, për presidentin francez, ata që,

kryesisht në Evropën Lindore, kritikuan ashpër, në maj 2022, deklaratën e tij se Rusia duhet "poshtëruar".

Në të njëjtën intervistë që dha të premten mbrëma në avionin që e çoi në Muni, Macron përsëriti se pëlqen një zgjidhje të negociuar. "Ajo që nevojitet sot është që Ukraina të nisë një ofensivë ushtarake që do të ndajë frontin rus për të realizuar një rikthim në negociatë", tha ai për tre medie franceze.

Macron argumentoi se "asnjë nga të dyja palët nuk mund të mbizotërojë as Ukraina, as Rusia, sepse rezultatet e mobilizimit nuk janë aq të rëndësishme sa parashikuan dhe ata (rusët) kanë mundësi të kufizuara".

Emmanuel Macron tha se "të gjitha opsionet e tjera, përveç Vladimir



Putini në sistemin aktual", i dukeshin "më keq" se presidenti rus, duke aluduar për kreun e Këshillit të Sigurimit të Ruisë,

Nikolai Patrushev dhe themeluesin mercenar të Wagnerit, Yevgeny Prigozhin. "A besojmë vërtet se një zgjidhje demokratike do të dalë nga

shoqëria civile ruse pas viteve të mizorisë dhe në mes të luftës? Shpresoj sinqerisht, por nuk besoj", përfundoi ai.

## Zelensky zotohet se Rusia do të përballet me "pasoja ligjore" për veprimet në Ukrainë



KIEV, 19 SHKURT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky është zotuar se "çdo sulm rus - në çdo cep të shtetit tonë - do të ketë pasoja konkrete ligjore për shtetin terrorist".

Gjatë fjalimit të tij me video të postuar mbrëmjen e 18 shkurtit, Zelensky tha se Kievi kishte "marrë sinjale të forta nga partnerët tanë dhe marrëveshje konkrete mbi pashmangshmërinë e mbajtjes së Ruisë përgjegjëse për agresionin dhe terrorin kundër Ukrainës dhe popullit të saj".

Ai tha se kjo do të bëhet "jo vetëm për të keqen që Rusia ka sjellë që nga

24 shkurti, por edhe për atë që nga viti 2014", duke iu referuar pushtimit nga Moska të rajonit të Krimesë të Ukrainës dhe nxitjes së një lufte separatiste në pjesë të Ukrainës lindore. Më 19 shkurt ushtria ukrainase tha se Rusia vazhdon të kryejë operacione sulmuese në disa zona të Harkivit, Donjeckut dhe Luhanskut. Përveç kësaj, Rusia kreu sulme ajrore kundër infrastrukturës civile në rajonet Hmelnytsky, Dnipropetrovsk, Donjeck dhe Herson, duke përfshirë më shumë se 50 sulme nga raketahedhës të shumtë. Rreziku i sulmeve raketore

në të gjithë Ukrainën mbeti i lartë, thuhet në deklaratën e ushtrisë ukrainase.

Deklaratat e Zelenskyt erdhën në të njëjtën ditë kur nënpresidentja amerikane Kamala Harris tha në Konferencën e Sigurisë të Muniut se "ShBA-ja ka përcaktuar zyrtarisht se Rusia kreu krime kundër njerëzimit" në Ukrainë.

Ajo tha, gjithashtu, se ShBA-ja do ta mbështesë Ukrainën "për aq kohë sa duhet".

Pushtimi rus i Ukrainës - që ka nisur më 24 shkurt 2022 - mbush një vit javën e ardhshme.

## Harris: Rusia ka kryer krime kundër njerëzimit në Ukrainë

WASHINGTON, 19 SHKURT - Zëvendëspresidentja amerikane Kamala Harris tha se Shtetet e Bashkuara kanë arritur në përfundim se Rusia ka kryer "krime kundër njerëzimit" në luftën e paprovokuar kundër Ukrainës, me forcat e saj që kanë ndjekur një sulm "të gjerë dhe sistematik" kundër civilëve në vend. Kështu tha ajo në Konferencën e Sigurisë së Muniut, një mbledhje e përvitshme e krerëve të shteteve, zyrtarëve, diplomatëve dhe ekspertëve, e cila po zhvillohet në Gjermani. "ShBA-ja ka përcaktuar zyrtarisht se Rusia ka kryer krime kundër njerëzimit", tha Harris, duke shtuar se veprimet e forcave ruse janë "një sulm ndaj vlerave tona të përbashkëta".

Harris përmendi një listë të abuzimeve nga forcat ruse në Ukrainë, duke përfshirë torturën

dhe përdhunimin, si dhe bombardimin e një materniteti në Mariupol, që vrau tre persona, në mesin e të cilëve ishte një fëmijë. "Le të biem dakord të gjithë: në emër të të gjitha viktimave, të njohura dhe të panjohura, drejtësia duhet të vihet në vend", tha Harris.

Ajo tha se ShBA-ja do ta mbështesë Ukrainën "për aq kohë sa duhet".

Mbështetja perëndimore për Ukrainën ka qenë në krye të agjendës në Konferencën e Sigurisë së Muniut.

Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha më 18 shkurt se aleatët duhet ta "dyfishojnë" mbështetjen ushtarake për Ukrainën.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, përsëriti thirrjet për aleatët perëndimorë për dërgimin sa më të shpejtë në Kiev të armëve, teksa hap i samitit treditör me

lidhje video më 17 shkurt.

Ai tha se Rusia nuk duhet të lejohet të blejë kohë për agresionin e saj derisa forcat ukrainase po përballeshin me sulme të shumta në të gjithë linjën e frontit. "Ne duhet të përshpejtojmë. Na duhet shpejtësi, shpejtësi në marrëveshje, shpejtësi në dërgesa, shpejtësi në vendime për ta kufizuar potencialin rus", tha Zelensky në Konferencën e Sigurisë në Muni.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, sipas raportimit të AFP-së, pritet të deklarojë se aleatët perëndimorë duhet t'i ofrojnë Ukrainës atë që i nevojitet për ta mposhtur Rusinë. "Ne duhet t'i japim Ukrainës atë që i nevojitet për të fituar dhe për të mbizotëruar si një komb sovran dhe i pavarur në Evropë", thuhet në fjalimin e tij të cilin e ka parë AFP.

Në konferencë po marrin pjesë



rreth 40 krerë shtetesh, si dhe politikanë dhe ekspertë të sigurisë nga pothuajse 100 vende, si liderët e Francës dhe të Gjermanisë, por edhe nënpresidentja amerikane Kamala Harris, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, dhe shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg. Gjatë konferencës, kancelari gjerman Olaf Scholz tha se

mbështetja e shtetit të tij për Ukrainën "është e dizajnuar që të jetë afatgjatë".

Ndërkaq, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se është jashtëzakonisht e rëndësishme që aleatët perëndimorë ta rritin ndihmën ushtarake në mënyrë që Ukraina të mund të nisë një kundërofensivë kundër Ruisë.

## Kurti bisedon me Scholzin për propozimin evropian

MUNIH, 19 SHKURT - Për propozimin evropian për normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë u fol në takim në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz, në Mynih të Gjermanisë, ku po mbahet një konferencë për sigurinë. Kështu thuhet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës të 18 shkurtit, ku u bë me dije se në këtë takim ishin të pranishme edhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ministrja për Evropë dhe Punë të Jashtme të Francës, Catherine Colonna.

Vitin e kaluar Kosovës dhe Serbisë iu dorëzua propozimi evropian, apo siç njihet edhe si propozimi franko-gjerman. Palët kanë konfirmuar se e pranojnë këtë dokument, por ai nuk është bërë publik. Megjithatë, aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejta të



barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për

komunitetin serb në Kosovë. Gjithashtu, në takim u diskutua edhe për përgatitjet për takimin e radhës në Bruksel, thuhet në njoftim. "Duke i falënderuar për

mbështetjen e vazhdueshme dhe angazhimin e drejtpërdrejtë të Gjermanisë dhe Francës, kryeministri Kurti tha se Republika e Kosovës, si vend pro-

evropian dhe pro-amerikan, mbetet e përkushtuar dhe konstruktive në dialog teksa dëshiron marrëdhënie të mira fqinjësore dhe integrim në BE dhe NATO", thuhet në njoftim.

Kosova dhe Serbia janë nën trysinë e komunitetit ndërkombëtar për të arritur një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve, nga frika se Rusia mund t'i shfrytëzojë tensionet mes tyre për të nxitur destabilizim në Ballkan, në përpjekje për ta zhvendosur vëmendjen nga agresioni i saj në Ukrainë. Aktualisht palët kanë në tryezë një propozim të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve, për të cilin ShBA-ja ka shprehur mbështetje.

Bartësit e dialogut, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pritet të takohen në Bruksel më 27 shkurt, për herë të parë që nga nëntori i vitit të kaluar.

## Tahiri: Asociacioni mund të çojë në ndryshimin e kufijve në Ballkan

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se formimi i një asociacioni njëetnik në Kosovë mund të dërgojë në ndryshimin e kufijve në Ballkan. "Nuk është veç pakica serbe në Kosovë, por në të gjithë shtetet e Ballkanit ka pakica etnike. Prandaj duhet një plan unik me standarde unike që të gjitha pakicave t'u jepet asociacion. Nëse faktori ndërkombëtar


insiston për asociacion me kompetenca ekzekutive për pakicën serbe, atëherë duhet t'u jepet të gjitha pakicave në Ballkan, ndërsa shqiptarëve në Maqedoni u takon statusi federal, sepse janë gjysma e popullatës atje", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Tahiri ka theksuar se nëse të gjithë pakicat bëhen me kompetenca etnike ekzekutive, atëherë bëhuni gati për ndryshimin e kufijve në Ballkan. "Ne Kosova nuk jemi

kundër sepse e realizojmë bashkimin kombëtar siç do ta bëjnë edhe kombet e tjera të ndara në Ballkan. Pas këtij argumentimi tim me Berlinin dhe Uashingtonin në kohën kur isha kryenegociatore në dialogun e Brukselit, u ndalën presionet e faktorit ndërkombëtar për kompetenca ekzekutive për asociacionin, gjë që rezultoi në marrëveshjen pa kompetenca ekzekutive për asociacionin në vitin 2015", ka shkruar Tahiri.



## Ambasadori Qehaja reagon ndaj deklaratave të Gjuriqit, i quan të neveritshme dhe të rrezikshme



Prishtinë, 19 shkurt - Ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Florian Qehaja, ka reaguar ndaj një deklaratë të ambasadorit të Serbisë në ShBA, Marko Gjuriq, i cili në "Twitter" ka shkruar se "jemi në një pikë kthese të historisë kur fati i popullit serb po vendoset në

të gjitha pjesët e hapësirës sonë historike etnike - nga Beogradi, rrafshi ynë verior, në Kosovë dhe në pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë ku jetojnë serbët...". Ndaj kësaj deklaratë ka reaguar ambasadori Qehaja duke thënë se janë të neveritshme dhe të

rrezikshme këto thirrje për ta mbrojtur botën serbe. "Një person që njihet gjerësisht për thirrjet e tij qesharake 'Aco-Srbine', tani bën një thirrje të hapur për ta mbrojtur botën serbe. Po aq e neveritshme dhe e rrezikshme", ka shkruar Qehaja.

## Osmani takohet me admiralin Munsch, flasin për zhvillimet e fundit të sigurisë

Prishtinë, 19 shkurt - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të Konferencës në Mynih, është takuar me admiralin Stuart B. Munsch - komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli. Zyra e Presidencës njofton se Osmani ka shprehur mirënjohje për punën e NATO-s në Kosovë. "Në

Mynih, në kuadër të Konferencës së Sigurisë, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani është takuar me Admiralin Stuart B. Munsch, Komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate të NATO-s në Napoli.

Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohje për punën e NATO-s në

Kosovë përgjatë këtyre 23 viteve në mbrojtje të sigurisë e stabilitetit. Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë, me ç'rast u potencua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë përdëris ballafaqohemi me këto sfida në rajonin tonë dhe përtej", ka njoftuar Presidencia e Kosovës.





## Njohjet, peng i marrëdhënieve me Serbinë

Njohja e fundit që mori Kosova ishte para dy vjetësh nga Izraeli. Para saj, për gati tre vjet, Kosova nuk u njoh nga asnjë vend. “Meqë në marrëdhëniet Kosovë - Serbi nuk ka ndryshuar asgjë tash e 15 vjet, shtetet që kanë qenë të pavendosura [për pavarësinë e Kosovës] nuk kanë pasur asnjë arsye për të ndryshuar qëndrim”, thotë Petr Cermak nga Shoqata për Çështje Ndërkombëtare e Çekisë. Një pjesë të fajit për këtë ai ua hedh edhe autoriteteve të Kosovës që, siç thotë, nuk e zbatuan Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, konkretisht pjesën për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Njohja e fundit që mori Kosova, ishte para dy vjetësh - nga Izraeli. Para saj, për gati tre vjet, Kosova nuk u njoh nga asnjë vend Prishtinë, 19 shkurt - Kur Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008, presidenti i atëhershëm i Shteteve të Bashkuara, George Bush, tha se historia do të tregojë se kjo është gjëja e duhur për paqen në Ballkan. “Në deklaratën e saj të pavarësisë, Kosova u angazhua për standardet më të larta të demokracisë, përfshirë lirinë, tolerancën dhe drejtësinë për qytetarët e të gjitha përkatësive etnike. Këto janë parime që nderojnë dinjitetin njerëzor, janë vlera që Amerika i kërkon te një mik dhe ne, së shpejti, do të vendosim marrëdhënie të plota

diplomatike me shtetin e ri të Kosovës”, tha Bush. ShBA-ja e njohu pavarësinë e Kosovës një ditë pas shpalljes së saj. Po atë ditë shteti më i ri u njoh edhe nga Shqipëria, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Afganistani e kështu me radhë. Sot, lista e njohjeve, e publikuar nga Ministria e Jashtme e Kosovës, numëron 117 vende. Gati gjysma e tyre u siguruan në vitin e shpalljes së pavarësisë, më 2008. Ritmi më pas nisi të ngadalësohet, përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi në vitin 2010 se “pavarësia e Kosovës nuk e shkel të drejtën ndërkombëtare”. Opinioni i saj këshillues ishte përgjigje ndaj pretendimeve të Serbisë se pavarësia e Kosovës

paraqet “shkelje flagrante” të integritetit të saj territorial. Por Serbia, në fakt, e humbi administrimin e ish-krahinës qysh në vitin 1999, kur bombardimet e NATO-s i dhanë fund luftës së saj në Kosovë.

Kosova u vu atëbotë nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe gati një dekadë më vonë - me mbështetjen e ShBA-së dhe të shumicës së shteteve evropiane - shpalli pavarësinë. “Deputetët e Kuvendit të Kosovës sot, më 17 shkurt 2008, shprehën vullnetin e tyre dhe, përmes tyre, vullnetin e qytetarëve të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik”, pati thënë kryetari i atëhershëm i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Pesëmbëdhjetë vjet më vonë Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe marrëdhëniet mes dy vendeve mbeten të tensionuara. Ky fakt, sipas disa ekspertëve të marrëdhënieve ndërkombëtare, e lë Kosovën në vendnumërim, jashtë organizatave të rëndësishme ndërkombëtare dhe pa numër më të madh njohjesh.

“Meqë në marrëdhëniet Kosovë - Serbi nuk ka ndryshuar asgjë tash e 15 vjet, shtetet që kanë

qenë të pavendosura [për pavarësinë e Kosovës], nuk kanë pasur asnjë arsye për të ndryshuar qëndrim”, thotë për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”, Petr Cermak nga Shoqata për Çështje Ndërkombëtare e Çekisë.

Njohja e fundit që mori Kosova ishte para dy vjetësh - nga Izraeli. Para saj, për gati tre vjet, Kosova nuk u njoh nga asnjë vend. Dinamika e njohjeve, në fakt, u ngadalësua nga viti 2015. Cermak thotë se kjo dinamikë ka qenë e pritur. Një pjesë të fajit për këtë ai ua hedh edhe autoriteteve të Kosovës që, siç thotë, nuk e zbatuan Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, konkretisht pjesën për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kjo, sipas tij, i ka dekurajuar sidomos pesë vendet mosnjohëse të BE-së - Greqinë, Spanjën, Rumaninë, Sllovakinë dhe Qipron - të cilat nuk duan shtete me probleme të tilla në radhët e veta. Cermak thotë se është e rëndësishme që Kosova të bëjë kompromise për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë dhe anasjelltas. “Nëse nuk ka marrëveshje midis

Prishtinës dhe Beogradit, një gjë e tillë do të ketë implikime të shtetet mosnjohëse të BE-së. E kjo është shumë e rëndësishme për Kosovën, sepse Kosova e ka shpallur integrimin evropian dhe integrimin euroatlantik si objektiva kryesore të politikës së jashtme. Ato nuk mund të arrihen pa njohjen e pesë vendeve anëtare [të BE-së]. Këtu e shoh rrezikun më të madh nga dështimi i marrëveshjes - rruga e Kosovës drejt BE-së do të bllokohet me vite të tëra”, thotë Cermak.

Qëndrim të ngjashëm ka edhe Stefan Lehne, ish-përfaqësues i Bashkimit Evropian në negociatat për statusin e Kosovës. “Mendoj se, në thelb, janë tri motive për mosnjohjen e Kosovës. I pari përfshin vendet që, në përgjithësi, janë skeptike ndaj nismave perëndimore. Do t'i përmendja Kinën, Indinë, Afrikën e Jugut... Pastaj janë vendet që kanë një miqësi të veçantë me Serbinë. Kjo, qartazi, është Rusia. Deri në një masë ndoshta edhe Greqia. Dhe vijjnë vendet që kanë vetë probleme me pakicat, çështje të pazgjidhura të statusit, kanë arsye të brendshme politike. Këtu e kam fjalën për Spanjën,

Qipron, Rumaninë, Sllovakinë... Pra, ka një përzierje motivesh. Dhe unë kam dyshime, që nëse Serbia nuk e njuh qartazi pavarësinë e Kosovës, këto vende që kanë probleme të mëdha të brendshme, si Spanja, Qiproja, do ta bëjnë të njëjtën gjë”, thotë Lehne për “Exposenë”.

Një qëndrim ndryshe ka Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në Shkollën e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike, si dhe në Qendrën për Analiza të Politikës Evropiane. Duke folur për “Exposenë”, ai thotë se përpjekjet e deritashme të komunitetit ndërkombëtar për t’i normalizuar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë nuk kanë dhënë rezultate. Sipas tij, është koha të mendohet për alternativa, që do t’i sillnin njohje Kosovës dhe do ta përfaronin atë me strukturat euroatlantike. “Është e rëndësishme që pesë vendet që

nuk e kanë njohur Kosovën, ta njohin atë. Është e rëndësishme që Spanja, Sllovakia, Qiproja, Rumania dhe Greqia të sillen në bord. Kjo mendoj se do t’i ofronte mundësi Kosovës që të anëtarësohet në BE dhe në NATO. Kjo, pastaj, do ta zgjidhte problemin e pasigurisë midis Beogradit dhe Prishtinës, pavarësisht nëse Serbia do ta njihje apo jo Kosovën”, thotë Hartwell.

Në pesë-gjashtë vjetët e fundit Serbia ka bërë edhe fushatë për çnjohjen e Kosovës. Dhe Lehne është i bindur se kjo ka ndikuar që të ngadalësohet ritmi i njohjeve. “Mendoj se Serbia ka bërë një fushatë shumë aktive për çnjohjen e Kosovës dhe ka pasur një sukses të kufizuar. Serbia beson se rreth 84 vende e njohin Kosovën, ndërsa Ministria e Jashtme e Kosovës thotë se janë 117 vende”, thotë Lehne.

Ministria e Jashtme e Kosovës nuk ka konfirmuar asnjë çnjohje. Hartwell thotë se Kosova nuk ka ndonjë rrezik nga to, edhe nëse kanë ndodhur. Sipas tij, pasojat janë vetëm simbolike. “Janë afro 200 shtete në botë. Pasojaat e tërheqjeve të njohjeve varen nga shtetet që vijnë. Serbia pretendon se Somalia, Burkina Faso, Gaboni, Esvatini, Libia, Guinea, Antigua e Barbuda, San Luçia e Maldivet e kanë tërhequr mbështetjen e tyre për Kosovën. Unë nuk mendoj se këto vende kanë peshë të konsiderueshme ekonomike apo politike në raport me Kosovën. Andaj, pretendimet e Serbisë se ato e kanë tërhequr njohjen janë të parëndësishme. Ndikimi në Kosovë është më shumë simbolik sesa domethënës”, thotë Hartwell.

Udhëheqësit politikë të Kosovës thonë, po ashtu, se cilësia është më e rëndësishme se sasia. Në

mesin e vendeve që e njohin Kosovën, janë 22 nga 27 vendet anëtare të BE-së dhe 26 nga 30 vendet anëtare të NATO-s. Lojtarë të mëdhenj, përfshirë ShBA-në, Japoninë, Korenë e Jugut, Australinë dhe Arabinë Saudite, e kanë njohur gjithashtu shtetin tashmë 15-vjeçar. Nga Ministria e Jashtme e Kosovës nuk japin detaje nëse janë duke lobuar për ndonjë njohje të re ose jo, por një gjë është e sigurt - mosnjohjet, në një mënyrë ose tjetër, e pengojnë Kosovën, nisur nga lëvizja e lirë deri tek anëtarësimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Një hulumtim që ka publikuar Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave - KIPRED, në vitin 2021, ka konstatuar se Rusia, përmes deklaratave, konferencave për shtyp dhe artikujve të ndryshëm, është duke bërë fushatë agresive kundër Kosovës. Sipas KIPRED-

it, Rusia vazhdimisht tenton t’i dëmtojë themelet e shtetësisë së Kosovës, duke synuar ta minimizojë edhe angazhimin e Perëndimit në Kosovë.

Rusia, një nga mbështetëset më të mëdha të Serbisë në arenën ndërkombëtare dhe me të drejtë vetoje në Këshill të Sigurimit, e pengon anëtarësimin e Kosovës edhe në Kombet e Bashkuara. Kosova nuk është ende as anëtare e Bashkimit Evropian, Organizatës Botërore të Tregtisë, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale e të tjera.

Por, gjatë 15 vjetëve të pavarësisë ajo ka arritur të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare - në mesin e tyre: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komiteti Olimpik, Federata Evropiane e Futbollit dhe Federata Botërore e Futbollit.



## Mbi 46 000 viktima nga tërmetet në Turqi dhe Siri

ANKARA, 19 SHKURT - Përpjekjet e shpëtimit në Turqinë e goditur nga tërmeti përfundojnë të dielën, gati dy javë pasi tërmetet vdekjeprurëse - 7.8 ballësh dhe 7.5 ballësh goditën Turqinë dhe Sirinë. Si pasojë e këtyre tërmeteve, më shumë se 46 000 njerëz - 41 044 në Turqi dhe 4 966 në Siri - kanë mbetur të vdekur.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, do ta vizitojë të dielën Turqinë, dhe do të diskutojë se si Uashingtoni mund ta ndihmojë më tej Ankaranë, teksa ajo po përballet me pasojat e tërmetit.

Kombet e Bashkuara janë duke u kërkuar vendeve anëtare që të

kontribuojnë me 1 miliard dollarë për t'iu ndihmuar miliona njerëzve të prekur nga tërmeti në Turqi, ndërsa 400 milionë dollarë për t'iu ndihmuar sirianët.

Gjithashtu, Kryqi i Kuq ka bërë thirrje për mbi 700 milionë dollarë ndihmë për viktimat e tërmeteve vdekjeprurëse që goditën Turqinë dhe Sirinë.

Javën e kaluar Kombet e Bashkuara ndanë një shumë prej 397 milionë dollarësh për të ofruar "ndihma dëshpërimisht të nevojshme për gati 5 milionë sirianë" për tre muajt e ardhshëm. Deri në marrëveshjen e 13 shkurtit midis OKB-së dhe qeverisë siriane të presidentit Bashar Assad,

ndihmat ishin lejuar të dërgoheshin vetëm në një zonë përmes një kalimi të vetëm kufitar me Turqinë, ose përmes territorit qeveritar.

Presidenti Assad ra dakord të hapë dy pika të reja kalimi nga Turqia në veriperëndim të vendit të kontrolluar nga rebelët për të ofruar ndihma dhe pajisje të nevojshme për miliona viktima të tërmetit.

Vendkalimet në BabAl-Salam dhe AlRae do të jenë të hapura për një periudhë fillestare prej tre muajsh. Më 6 shkurt Turqia dhe Siria u goditën nga tërmete prej 7.8 dhe 7.5 ballësh, që u pasuan me qindra dridhje të tjera të tokës.



## Mustafa: ShBA-ja, Gjermania dhe Franca ta sqarojnë a kanë kundërshti me Kurtin, i ndihmuan të vijë në pushtet

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, beson se Kosova 15 vjet më vonë, në 30-vjetorin e pavarësisë, mund të bëhet anëtare e NATO-s dhe OKB-së, por dyshon se deri atëherë mund të hyjë në Bashkimin Evropian.

Për këtë 'parashikim' qysh tani meritat ia lë ShBA-së, por nuk heziton të kritikojë ndaj Uashingtonit, Berlinit e Parisit që, sipas tij, e kanë ndihmuar Kurtin të vijë në pushtet. "Pa të keqe duhet ta them se Kurti i ka marrë votat nga qytetarët që ta kundërshtojë Perëndimin", thotë Mustafa kur pyetet nëse po shih përplasje mes Kurtit dhe qeverive perëndimore që po bëjnë presion për marrëveshje me Serbinë. "Është përkrahur nga Gjermania, Franca, por jo pak edhe nga ShBA-ja për të ardhur në pushtet. Prandaj, vetëm këta e dinë tani se



çfarë kanë dhe si qëndrojnë ndërmjet vete, a e kanë seriozisht apo po luajnë lojëra", ka theksuar Mustafa në një intervistë për "Express".

Duke i komentuar përpjekjet e

Perëndimit për një marrëveshje Kosovë - Serbi me anë të propozimit evropian, Mustafa thotë se plani do t'i qetësonte serbët në Veri, por jo edhe Serbinë nga qëllimet për ta minuar

Kosovën.

Sidoqoftë, destinacionin final ku do të çojë kjo marrëveshje, Mustafa thotë se s'mund ta parashikojë meqë "derisa s'ke informata, je i verbër". Por, këtu ai

mund të shohë se marrëveshja e prezantuar në planin franko-gjerman do të prodhojë edhe marrëveshje të tjera, për të cilat thotë se qeveria duhet t'i sqarojë. Politikani veteran në një intervistë për gazetën Express ka pranuar se qeverisjet në Kosovë, në faza të caktuara, janë sjellë papërgjegjshëm, përfshirë edhe atë të Kurtit. "Për fat të keq, qeverisja në cikle të caktuara është treguar joefektive dhe e papërgjegjshme. Edhe në ditën e sotme!".

Ndonëse shpreson se vendit mund t'i hapet perspektiva e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, përfshirë OKB-në ku duhen evituar vetot ruse e kineze, ai përgjigjet me ironi kur pyetet si mund të ndodhë kjo. "Ndoshta kanë ide Vjosa dhe Albini, të cilët çdo ditë po 'luftojnë' me Rusinë", ka theksuar Mustafa.

## Orbani thotë se Evropa është indirekt e përfshirë në luftë me Rusinë

BUDAPEST, 19 SHKURT - Kryeministri hungarez Viktor Orban tha se Evropa është e përfshirë "indirekt në luftë me Rusinë", pasi disa vende evropiane zotohen të dërgojnë tanke luftarake për ta ndihmuar Ukrainën që ta luftojë pushtimin rus.

Orban, i cili u rizgjodh kryeministër në vitin 2022 për një mandat të katërt radhazi, përsëriti se të qenit anëtar i NATO-s është "jetike" për Hungarinë, por tha se qeveria e tij nuk do të dërgojë armë në Ukrainë e as nuk do t'i ndërprejë marrëdhëniet

ekonomike me Moskën.

Më 25 janar qeveria gjermane iu përgjigj thirrjeve të përsëritura të Kievit dhe miratoi dërgimin e tankeve Leopard 2 në Ukrainë si dhe rieksporin e tyre nga vendet partnere.

Në të njëjtën ditë, presidenti amerikan Joe Biden njoftoi se ShBA-ja do t'i dërgojë 31 tanke luftarake M1 Abrams në Ukrainë. Tanku Leopard 2 konsiderohet si një nga më të mirët në vendet perëndimore dhe rreth 20 vende aktualisht përdorin këtë tank.

Ukraina ka kërkuar 300 tanke të

tilla dhe thotë se Perëndimi deri më tani ka premtuar se do t'ia dërgojë të paktën 120.

Më 9 shkurt, pas takimit me presidentin e Ukrainës Volodymyr Zelensky në samitin e Bashkimit Evropian në Bruksel, Orban tha se Budapesti "i përket kampit të paqes".

Hungaria ka kritikuar vazhdimisht sanksionet e BE-së ndaj Rusisë dhe deri në një marrëveshje të arritur në dhjetor, bllokoi një paketë ndihme prej 18 miliardë eurosh të BE-së për Ukrainën.



# Ngritja e vazhdueshme e çmimeve të konsumit, kërkohet reflektim i qeverisë

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kohën e fundit ka ngritje të çmimeve të artikujve ushqimorë bazë qoftë të prodhuesve vendorë, qoftë ata që importohen. Ekonomistët vlerësojnë se qeveria duhet të reflektojë karshi kësaj situatë. Rritja dyshifrore e inflacionit që ka varfëruar shportën e konsumatorit pothuajse e ka karakterizuar Kosovën gjatë vitit paraprak, por edhe këtë vit. Qytetarët thonë se kjo rritje e çmimeve të produkteve bazë ushqimore është jonormale. "Shumë shtrenjtë. Gjithçka prej produkteve. Kjo është jonormale për xhepat tanë të varfër", tha një qytetar.

Kryetari i Shoqatës "Konsumatorit", Selatin Kaçaniku, thotë për Radio Kosovën se qytetari konsumator me këto veprime është jashtëzakonisht i dëmtuar. "Ky dëmtim na vjen përmes indinjatës, sepse qeveria nuk

është duke e bërë gjënë e duhur. Këto dëme në këto rrethana janë shumë më të mëdha, sepse pas kësaj qeveria po dëshmon se as të drejtat themeltare të njeriut nuk po përfillen. Qytetari konsumator nuk po përfilllet më e ky duhet të jetë alarm", ka deklaruar Kaçaniku.

Profesori i ekonomisë, Musa Limani, mendon se Kosova me inflacion po përballlet që nga viti 2020. "Që nga viti 2020 Kosova po përballlet në mënyrë permanente me rritje të inflacionit, në veçanti të produkteve jetësore të shportës jetësore, të atyre artikujve që janë në listën e ekzistencës së popullatës", ka theksuar Limani. Edhe njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, vlerëson se prioritetet politike gjithmonë kanë lënë në hije çështjet ekonomike. "Është koha kur duhet të ketë diçka konkrete, e them për herë të parë se tash nuk duhet të pritët më nga qeveria të bëjë diçka më tepër,



sepse tregtia spekulative po e bën të vetën. Efektin më të madh që mund ta bëjë qytetari është që duhet qytetari konsumator të mos konsumojë në masë të

panevojshme dhe në masë të tillë, tregtarët të ndryshojnë çmimet dhe të ketë çmime më të ulëta", tha Gërxhaliu. Sipas parashikimeve të fundit nga

Banka Qendrore e Kosovës, parashihet se norma mesatare e inflacionit për vitin 2023 pritët të bie në 6.2 për qind, sa ka qenë nga 11.6 për qind në vitin paraprak.

## Rafuna: Ekonomia e vendit, nën hijen e zhvillimeve politike



PRISHTINË, 19 SHKURT - Tema e dialogut Kosovë - Serbi dhe zhvillimet politike në vend kanë lënë nën hije ekonominë e vendit tonë në një dekadë e gjysmë. Për 15 vjet shtet Kosova nuk ka arritur të krijojë qëndrueshmëri ekonomike si rrjedhojë e dialogut dhe zhvillimeve në veri të vendit, ka thënë kryetari i Odës Ekonomike (OEK), Lulzim Rafuna. Kreu i OEK-ut thotë se investime, mirëqenie për qytetarët dhe siguri më të madhe për bizneset mund të ketë vetëm atëherë kur do të marrë fund dialogu me Serbinë me një marrëveshje finale. Rafuna ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të ketë në prioritet

zhvillimin ekonomik, njëkohësisht t'u dalë në krah bizneseve. Në 15-vjetorin e pavarësisë, Rafuna u ka bërë thirrje qytetarëve të konsumojnë sa më shumë prodhimet vendore "Made in Kosova", për ta forcuar, siç ka thënë ai, ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. "Ajo që kohë pas kohe ka shkaktuar një pasiguri, kanë qenë tensionet politike. Kur e them këtë e kam fjalën në veri të vendit. Prandaj, është shumë me rëndësi stabiliteti politik. E kishim rastin e fundit me mbylljen e rrugëve në veri. Kjo nuk ka qenë një pasqyrë e mirë për investitorët e huaj. Ne e kemi rastin kur bizneset përkohësisht kanë

pezulluar dërgimin e mallit ose lidhjen e kontratave derisa situata të qetësohet. Kështu që ne duhet të kemi një stabilitet më të madh. Edhe çështja e dialogut Kosovë - Serbi sa më shpejt që të përfundojë është në të mirën e ekonomisë", ka theksuar Rafuna. Ai ka theksuar se në momentin që merr fund çështja e dialogut, hapen mundësitë edhe për investime dhe biznesi ndihet më i sigurt. "Kështu që këto kanë qenë sfidat më të mëdha dhe shpresoj që në të ardhmen të mos ketë më pengesa dhe të ketë një stabilitet e mundësi më të madhe për bizneset tona, për investime dhe zgjerimin e kapaciteteve

ekzistuese. Dhe kështu ekonomia të rritet duke ulur edhe normën e papunësisë dhe rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve", shton ai. Megjithatë, kryetari i OEK-ut ka shprehur optimizëm se në vitet e ardhshme do të ketë më shumë zhvillim ekonomik. Po ashtu, ai ka theksuar se ka sinjale pozitive se këtë vit do të ketë rënie të inflacionit. Rafuna ka theksuar se si odë janë të përkushtuar për promovimin e produkteve vendore. "Oda Ekonomike në dy muajt e fundit ka krijuar edhe Shoqatën e Prodhuesve për promovimin e produkteve tona vendore. Po

ashtu u bëjmë me dije të gjithë qytetarëve se prodhimet vendorë janë produkte kualitative. Çdo ditë i vizitoj prodhuesit tanë dhe jam lumtur që produktet e tyre kanë depërtuar në tregjet ndërkombëtare. Prodhimet vendore janë me standarde të larta dhe me çmime konkurruese. Kështu që thirrja ime është që të konsumohen sa më shumë produkte vendore, sepse në këtë mënyrë ne i ndihmojmë prodhimet vendor dhe kështu ulet papunësinë dhe ngrihet mirëqenia e qytetarëve. Pra, t'i konsumojmë së pari produktet vendore, pastaj ato që importohen", ka pohuar Rafuna për "KP".

# Si i zgjidhin arkeologët misteret e mijëra viteve më parë?



Autopsi, skanime të kompjuterizuara, analiza të gjurmëve të gishtërinjve, teste kimike dhe biologjike mbi materiale të të gjitha llojeve, të kryera nga ekspertë me veshje të bardha, që janë të gatshëm t'i vlerësojnë ato në detaje. Nuk po përshkruajmë skenën e një episodi të serialit "C.S.I.", por punën e përditshme të arkeologëve, e cila është sot shumë e ngjashme me atë të agjentëve policisë shkencore.

Pra ata janë të aftë të rindërtojnë historinë e njerëzve, kafshëve, bimëve dhe objekteve, shpeshherë duke iu përgjigjur pyetjeve mijëra vjeçare. Në realitet, bashkimi mes arkeologjisë dhe shkencës lindi pas Luftës së Dytë Botërore, kur figura e "gjuetarit të thesarit" u zëvendësua përfundimisht nga ajo e një profesionisti me aftësi ndërdisiplinore gjithnjë e më të mëdha.

"Pika e kthesës ndodhi në vitet 1960, kur në SHBA lindi e ashtuquajtura arkeologjia e re ose "arkeologjia procesuale". Ajo lëvizje mbështeti nevojën për një dialog me të gjitha shkencat, përfshirë matematikën dhe statistikën, në mënyrë që të ekstrapolohen të dhëna të dobishme për të analizuar më mirë gjetjet"- thotë Silvia Paleki, profesoreshë e metodologjive të kërkimit arkeologjik në Universitetin e

Xhenovas, Itali.

Me fjalë të tjera, arkeologjia e re aplikon metodën eksperimentale tashmë të njohur dhe të përdorur në disiplinat shkencore. Për të rindërtuar sa më mirë të kaluarën, studiuesit duhet të jenë në gjendje të shtjellojnë teori të përgjithshme, që janë logjike dhe të verifikueshme, duke u mbështetur jo vetëm tek historia, por edhe në fusha të tjera.

Për shembull gjeologjia, botanika apo zoologjia, mund të na tregojnë se si ka evoluar marrëdhënia e të parëve tanë me zonën përreth. "Arkeozoologjia, ose më saktë disiplina që studion mbetjet e kafshëve të gjetura në sítet arkeologjike, është një nga specializimet që i përket plotësisht kësaj qasjeje të re.

Për shembull, duke analizuar moshën e therjes, gjininë dhe karakteristikat e tjera së kafshëve të gjetura në vendet arkeologjike, ne mund të kuptojmë më mirë zakonet e të ngrënit, ato kulturore dhe ekonomike të komuniteteve të tëra, duke qenë gjithashtu në gjendje që të matim mënyrën se si ka ndryshuar pasuria e njerëzve".

Ajo që i dha një shtysë të mëtejshme parimeve të arkeologjisë procedurale ishte futja e një teknike hetimore revolucionare: e ashtuquajtura

"metoda e karbonit 14" (apo radiokarbonit), falë së cilës është e mundur të përcaktohet me saktësi të madhe koha e objekteve të gjetura dhe të përbëra nga materiale organike, si jashtëqitjet e njerëzve dhe kafshëve, bimëve etj.

Në këtë proces përdoret një nga izotopet radioaktivë të karbonit (karboni 14), i pranishëm tek gjallesat, dhe që karakterizohet nga një shkallë konstante dhe e njohur e shpërbërjes. Sapo vdes një qenie e gjallë, pushon edhe thithja e këtij elementi, që më pas fillon procesin e dekompozimit "Meqë kemi mundësi të vlerësojmë sasinë e Karbonit 14 të pranishëm në një trup kur ai është gjallë, për të përcaktuar kohën e kaluar që nga vdekja e tij, është njëllor si të kemi 'numëruar' sa sa atome janë ende të pranishme tek mbetjet e gjetura, duke gjurmuar kështu moshën e tij të saktë"- shpjegon Paleki.

Sot teknika e radiokarbonit na lejon të datojmë artefakte deri në 60 mijë vjet të vjetra, megjithatë zbulimi i tij nuk ka pasur në fillim lidhje me arkeologjinë. Gjithçka nisi nga studimet mbi fotosintezën, të kryera në vitin 1940 nga dy studiues të Universitetit Amerikan të Berklit, Martin Kamen dhe Sam Ruben, të cilët ishin të parët që vunë re radioaktivitetin karakteristik të

këtij elementi.

Disa vite më vonë, kimisti Uillard Libi i Universitetit të Çikagos, zhvilloi metodën e sotme dhe arriti të datojë saktësisht fragmentin e një anijeje të lashtë egjiptiane, mosha e së cilës tashmë dihej me siguri nga historianët. Në vitin 1960, Libi fitoi Çmimi Nobel për Kimi, dhe teknika e tij solli një revolucion të madh në kërkimet arkeologjike.

Një tjetër aleat i arkeologëve të sotëm është mjekësia, falë së cilës është shpesh e mundur të rindërtohen me saktësi shumë të madhe "të dhënat klinike" të burrave dhe grave që kanë jetuar mijëra vjet më parë. Në këtë rast, në skenë hyjnë paleopatologët, mjekë me aftësi arkeologjike (apo anasjelltas), të specializuar në studimin e sëmundjeve të së shkuarës.

Falë tyre ne mund të identifikojmë karakteristikat kryesore fizike të një të ndjeri dhe praninë e patologjive kur ai ishte gjallë. Ndër studimet më të famshme të tyre ka qenë natyrisht faraoni Tutankhamun (mijëvjeçari II Para Krishtit), mumja e të cilit, e gjetur në vitin 1925, i është nënshtruar me kalimin e kohës analizave të ndryshme mjekësore: rreze X, tomografi e kompjuterizuar dhe analiza e ADN-së.

Ato zbuluan se Tutankhamun ishte fryt i bashkimit midis faraonit Akhenaton dhe motrës

së tij, identiteti i së cilës nuk dihet ende me saktësi. Ndërkaq disa skanime CT zbuluan shkaqet e sëmundjeve të faraonit të ri, si çalimi, për shkak të sindromës Freiberg-Köhler. Po ashtu gjetën tek mumja një patogjen që shkakton një formë të rëndë të malaries, e cila ishte ndoshta arsyeja e vdekjes së tij.

"Në thelb, ne arkeologët përdorim të njëjtat metoda si mjekët dhe detektivët, duke u përpjekur të shpjegojmë shkaqet e ngjarjeve, në të cilat nuk kemi qenë vetë dëshmitarë. Ndaj nuk është rastësi që arkeologët bashkëpunojnë ndonjëherë me policinë shkencore dhe me institute prestigjioze të mjekësisë ligjore si Labanof, Laboratori i Antropologjisë Ligjore dhe Odontologjisë të Universitetit të Milanos"- thekson Paleki.

Ndërkaq arkeologjia është shndërruar vitet e fundit edhe në një shkencë të teknologjisë së lartë, duke u mbështetur tek Inteligenca Artificiale. Një shembull është projekti ArchAIDE, i zhvilluar në vitin 2019 nga Universiteti i Pizës, që lejon njohjen dhe datimin automatik të fragmenteve të qeramikës përmes një aplikacioni të veçantë të bazuar tek një teknologji engjashme me atë të njohjes së fytyrës. Pra hetimet mbi të kaluarën e njerëzimit nuk ndalen. Ka ende shumë për të zbuluar. / Focus - Bota.al



# Në fillim ishte hudhra: Ekonomia e shpjeguar me ushqimin



## Ha-Joon CHANG

Që në zanafillën e kohës, qeniet njerëzore vuajtën në kaos dhe injorancë (që atëhere nuk kanë dëshiruar shumë gjëra). Hwanoong, princi i mbretërisë qiellore, zbriti në Tokë për të vizituar vendin ku ndodhet sot Koreja dhe themeloi Qytetin e Zotit. Brenda qytetit ai krijoi racën njerëzore, dhe i dha asaj ligjet dhe njohuritë mbi të bujqësinë, mjekësinë dhe artet. Një ditë Hwanoong-ut iu afrua një ari dhe një tigër. Ata kishin qenë dëshmitarë të asaj që ai kishte bërë, dhe duke parë se si kishte filluar të funksiononte bota, dëshironin të ndryshonin statusin e tyre dhe të bëheshin njerëz. Hwanoong u premtoi atyre se – nëse shkonin në një shpellë, shmangnin rrezet e diellit dhe hanin vetëm manul (hudhra) për 100 ditë – ai do t'i kthente në qenie njerëzore. Kafshët vendosën të ndiqnin udhëzimet dhe hynë në një shpellë shumë të thellë. Por pas disa ditësh tigrin u rebelua. “Kjo është qesharake. Unë nuk mund të jetoj duke ngrënë një bimë me erë të keqe dhe gjethe të hidhura. Po iki” – tha ai dhe u largua nga shpella. Ariu rezistoi me dietën që iu

rekomandua, dhe pas 100 ditësh u shndërrua në një grua të bukur, Woong-nyeo (arusha). Ajo u martua me Hwanoong dhe pati një djalë që u bë mbreti i parë i Koresë, Dan-Goon. Pra kombi im, Koreja, u themelua nga hudhra, dhe kjo është më se e dukshme....Nëse e keni jetuar gjithë jetën mes atyre që janë të fiksuar pas hudhrave, mund të mos e kuptoni se sa hudhra jeni duke ngrënë. Kjo është ajo që më ndodhi në fundin e korrikut të vitit 1986, kur në moshën 22-vjeçare i hipa avionit nga Koreja për të shkuar dhe filluar studimet e mia në Universitetin e Kembrixhit....Trauma e parë që përjetova kushte të bënte me ushqimin. Në Kore më kishin paralajmëruar (nga librat, pasi pak koreanë kishin qenë atje vetë, se ushqimi në Britani nuk ishte më i miri i mundshëm). Por nuk e mendoja se do të ishte realisht aq i tmerrshëm...Kultura britanike e ushqimit në vitet 1980 ishte tepër konservatore. Britanikët nuk konsumin asgjë të panjohur. Ushqimi i konsideruar i huaj, shihej prej tyre me një skepticizëm thuajse fetar dhe me një neveri të madhe. Përveç ushqimeve

kineze, indiane dhe italiane, të cilat ishin plotësisht të anglikanizuara dhe përgjithësisht me një cilësi të dobët, nuk kishte asnjë kuzhinë alternative, përveçse nëse shkoje në Soho apo në ndonjë zone tjetër të sofistikuar të Londrës. Për mua, konservatorizmi britanik i ushqimit mishërohej në zinxhirin e dyqaneve “Pizzaland”, që sot është zhdukur ndërsa dikur dominonte. Duke e kuptuar se pica mund të jetë “e huaj”, menyja i joshte klientët me opsionin e një pice të mbushur me patate të skuqura. Natyrisht, si në të gjitha diskutimet mbi të huajt, ky qëndrim duket absurd kur analizohet sot. Sot dreka e dashur e Krishtlindjeve në Britani përbëhet nga gjeli i detit (si në Amerikën e Veriut), patatet (si në Peru), karotat (si në Afganistan) dhe lakrat e Brukselit (si në Belgjikë). Por kjo gjë nuk ka rëndësi. Asokohe britanikët nuk donin të kishin të bënin me të huajt. Nga të gjithë përbërësit “e huaj”, armiku i tyre kombëtar dukej se ishte hudhra...Britania e sotme është bërë një vend i mrekullueshëm për të ngrënë. Londra i ka të gjitha – donerin

dheqebapin turk, të lirë por me një shije të shkëlqyer, që mund të konsumohet dhe në orën 1 të mëngjesit, i përgatitur nga një shitës ambulant në rrugë; darkën japoneze kaiseiki që për krahasim është shumë më e shtrenjtë; dhe gati çdo gjë tjetër. Shijet variojnë nga gjellët koreane të veçanta dhe të pangatërrueshme në shije, deri tek gatimet polake plot kalori. Ju mund të zgjidhni midis kompleksitetit të pjatave peruane – me rrënjë iberike, aziatike dhe inkaso, por edhe shijes së thjeshtë të biftekut argjentinas.... Që nga vitet 1980, ekonomia është bërë si kulinaria britanike e para viteve 1990. Një traditë –ekonomia neoklasike – është bërë i vetmi artikull në meny. Si të gjitha adresat e tjera, ajo ka pikat e saj të forta, por ka edhe kufizime serioze....Disa lexues mund të pyesin me të drejtë: Pse duhet të më interesojë mua, nëse një grup studiuesit kanë fituar një mentalitet mendje-ngushtë dhe angazhohen në një monokulturë intelektuale? Përgjigja ime mund të fillojë nga vënia në dukje se vlerësimi i ekonomisë nuk i ngjashëm për shembull me vlerësimin e

studimit të gjuhës norvegjeze apo identifikimin e planetëve të ngjashëm me Tokën që ndodhen qindra vite dritë larg nga këtu. Ekonomia ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe shumë të madh mbi jetën tonë. Të gjithë e dimë se teoritë ekonomike ndikojnë tek politikat qeveritare për taksat, shpenzimet sociale, normat e interesit dhe rregulloret e tregut të punës, të cilat nga ana e tyre ndikojnë tek kushtet tona ekonomike individuale, por edhe tek kushtet e punës, pagat dhe tarifat e rimbursimit për shpenzimet tona, kreditë apo huatë studentore. Por teoritë ekonomike diktojnë gjithashtu edhe perspektivën kolektive afatgjatë të një ekonomie, duke ndikuar tek politikat që përcaktojnë aftësinë e saj për t'u përfshirë në industri me një produktivitet të lartë, inovacion dhe një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. Por përtej kësaj: ekonomia nuk kufizohet vetëm në ndikimin e variablave ekonomike, si personale ashtu edhe kolektive. Prandaj duhet të ndryshojmë qasjen tonë.

Marrë nga libri “Ekonomia e ngrënëshme” i Ha-Joon Chang, / “Linkiesta” – Bota.al

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Invert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Trepça fiton Kupën për meshkuj, Bashkimi për femra

**MITROVICË, 19 SHKURT** - KB Trepça është fituese e Kupës së Kosovës, duke mbrojtur trofeun e fituar vitin e kaluar. Mitrovicasit në finale mundën Sigal Prishtinën me rezultat 74:66 (17:20, 24:20, 17:18, 16:8). Çerek i parë ishte tërësisht i barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shpërbente në rezultat dhe herë njëra kalonte në epërsi e herë tjetra, derisa përfundoi 17:20. Ngjashëm ishte edhe periudha e dytë, që zhvillohej në atmosferë mbresëlënëse dhe me motiv të madh për fitore, derisa përfundoi 41:40. Edhe periudha e tretë ishte tërësisht e barabartë, duke bërë që gjithçka të vendoset në dhjetë minutat e fundit. E në minutat e fundit, mitrovicasit ishin më të



vëmendshëm, duke triumfuar 74:66. Medaljet i kanë ndarë kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza dhe

Valton Bilalli, anëtar i Bordit të FBK-së. MVP i Final 8 është shpallur Drilon Hajrizi, çmim të cilin ia kanë ndarë Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ndërsa trofeun Valdrin Haxhiut ia dorëzoi kryetari i FBK-

së, Arben Fetahu. Bashkimi ka arritur ta mbrojë Kupën e Kosovës duke fituar ndaj Prishtinës me rezultat 94:72 (23:22, 19:16, 27:15, 25:19). Vajzat prishtinase e nisën më mirë çerekun e parë me seri 12:2, por në fund të çerekut të parë pas rikthimit të Bashkimit, në semafor shifrat ishin 23:22 në anën e Bashkimit. Periudha e dytë ishte më e barabartë për dy skuadrat, ku vajzat nga Prizreni shkuan në pushim me katër pikë diferencë, apo me rezultat 42:38. Periudha e tretë e takimit ishte tërësisht në anën e skuadrës prizenase, që thelluan epërsinë në 69:53. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte dallim të madh dhe Bashkimi fitoi sërish Kupën me rezultat 94:72. Medaljet për

vendin e parë i kanë ndarë, Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme në Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe ish basketbollistja e njohur Resmije Juniku. Ndërsa medaljet e argjendta i kanë ndarë Leart Hoxha, anëtar i bordit të FBK-së dhe Adriatik Rraci, Menaxher i Përfaqësuesve të Kosovës. Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës Arben Fetahu ka ndarë mirënjohje për gjyqtarët dhe vëzhguesin e ndeshjes, si dhe trofeun e MVP-së për Khadija Haywood. Kupën kapitës Aulona Muadri e dorëzoi Kryetari i Federatës së Basketbollit Arben Fetahu dhe zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani.

## Ballkani vazhdon me fitore, Malisheva merr një pikë në Gjilan

**PRISHTINË, 19 shkurt** - Kampioni në fuqi, Ballkani, ka realizuar fitoren e dytë radhazi në stinorin pranveror, përkatësisht të 13-tën në këtë edicion në Albi Mall Superligë, duke ruajtur epërsinë prej tre pikësh në kreun e renditjes ndaj skuadrës rivale për titull, Dritës. Megjithatë, deri te fitorja para tifozëve të vet në kuadër të javës së 20-të, skuadra e Ilir Dajës vuajti goxha shumë përballë Drenicës. Në fakt, ishin kuqezinjtë e Skenderajt, ata që shënuan të parët, kur Bintsouka Koxy, realizoi në minutën e 8-të. Mirëpo, ashtu

sikurse një javë më parë, edhe këtë herë për fitoren e portokallezinjve u përkujdes sulmuesi i shkathtë, Albion Rrahmani, i cili fillimisht në minutën e 25-të barazoi shifrat, derisa në minutën e 88-të vulosi fitoren pas asistimit të Gripshit. Ndeshja tjetër ndërmjet Gjilanit dhe Malishevës ka prodhuar gola, por jo edhe fitues. Pas një loje mjaft interesante në fund skuadrat janë ndarë baras, 2:2. Malisheva ishte dy herë në epërsi, por në të dyja rastet gjilanasit arritën të rikthehen. Për skuadrën mysafire



realizuan Ronald Sobowale (18') dhe Bleart Tolaj (64'), derisa për Gjilanasit golat i

shënuan Albert Dabiqaj (30') nga penalltia dhe Mevlan Zeka (80'), i cili dështoi nga pika e

bardhë, por topin e dëbuar nga portieri e dërgoi në rrjetë. Injeksi futbollist në minutat shtesë realizoi nga afërsia me kokë, por goli u anulua nga VAR, pasi paraprakisht kishte pozitë jashtëloje. Gjilani edhe pas këtij barazoi vazhdon ta mbajë pozitën e tretë, me 29 pikë, derisa Malisheva renditet e teta, me 20 pikë. Të shtunën janë zhvilluar tri ndeshjet e tjera, ku Drita ka fituar bindshëm ndaj Dukagjinit (5:1), Llapi ishte më i mirë se Trepça'89 (2:1), derisa Ferizaj mposhti Prishtinën (1:0). Ndeshjet e javës së 21-të luhen në mesjavë.

## Rahoveci fiton derbin me Prishtinën



**PRISHTINË, 19 SHKURT** - Rahoveci e ka fituar derbin e xhiros së 17-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Të dielën mbrëma, Rahoveci e mposhti Prishtinën në kryeqytet me rezultat 34:31. Ndeshja ishte e fortë dhe shumë interesante. Në pjesën e parë në epërsi ishin herë njëra e herë skuadra tjetër. Vreshtarët u shpërbente deri në

tri gola në minutat e fundit. Në minutën e 44-t, Prishtina ia doli të barazojë rezultatin, ndërsa më pas kaloi në epërsi 23:22. Prishtina vazhdoi me lojë të mirë dhe u shpërbente deri në tri gola (28:25), por mysafirët nuk u dorëzuan dhe kthyen epërsinë, 30:29. Më pas krijuan edhe epërsi prej tri golave, 34:31 për fitore të madhe.

Marley Wallace Fernandes shkëlqeu me 11 gola. Shtatë i kishte Alban Haziri, por kontribut për fitore dhanë të gjithë lojtarët e Rahovecit. Te Prishtina më efikas ishte Oltion Beshiri me 7 gola. 6 i kishte Sergio Barreto. Në ndeshjen tjetër të së dielës, Trepça fitoi ndaj Llapit në Podujevë me rezultat 48:24.

## Barcelona e pagabueshme në La Liga

**BARCELONË, 19 SHKURT** - Gjithçka ka shkuar më së mirë për Barcelonën, në "Camp Nou", me "blaugranat" që kanë triumfuar me rezultatin e pastër 2-0, ndaj "diletantëve"

të Cadiz, në një përballje të vlefshme për kampionatin spanjoll të futbollit, La Liga. Dy gola që në fundin e pjesës së parë mjaftuan për të "hipotekuar" 3 pikët e radhës drejt titullit kampion.

Fillimisht Sergi Roberto në minutën e 43' dhe Robert Lewandowski vetëm 3 minuta më pas, mjaftuan për djemtë e Xavit, që të siguronin fitore. Fitore kjo, që i ngjiti në kuotën e 59 pikëve,

8 më shumë se rivalët e Real Madrid në vendin e dytë. "Blaugranat" tashmë duhet të mendojnë për mbrëmjen e së enjtes, ku do të përballen me "djajtë" e Manchester United, në "Old Trafford".





KE: 0390/ 320 010  
E-mail: nplsagj@gmail.com  
Info: 0390/ 324 268  
Web:

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.  
GJAKOVË

Komuna e Gjakovës  
Opština Dajkovica Gjakova Municipality  
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.  
GJAKOVË

Nr: 49  
Data: 16.02.2023

NU: 811444900  
Nr. TVSH: 330311853  
BEK: 1402000001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Marrëdhënien në Punë të Punëtorëve dhe vendimit nr. 78 të datës 16.02.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, shpallë këtë:

## KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

### I. Pozita e punës: Asistent/e Administrative e Kryeshefit Ekzekutiv

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

#### Kushtet:

- Kandidati/ja duhet të ketë kryer shkollën e mesme;
- Ai/Ajo duhet të ketë shkathtësi të dëshmuar në administratë dhe njohuri të procedurave bashkëkohore të punës në zyre duke përfshirë edhe njohurin për përpunimin e tekstit;
- Kandidati/ja duhet të ketë së paku një vit përvojë pune në punët administrative;
- Njohuria e gjuheve të huaja, si ajo angleze është përparesi.

#### Detyrat e punës:

- Është përgjegjëse për pranimin e palëve të KE, përkatesisht caktimin e termineve të takimeve të KE me palët;
- Pranon postën dhe pas kontrollimit nga KE, bën shpërndarjen e të njejtës;
- Mban evidencën dhe përkujtuesin e punëve dhe takimeve të KE;
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë të materialit shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të KE për reprezentacion brenda Ndermarrjes;
- Kujdeset për mirembajtjen përkatësisht kushtet higjieniko-teknike të zyrës së KE;
- Është përgjegjëse për përdorimin dhe pranimin e e-maileve zyrtar të Ndermarrjes;
- Është personi si dhe pika e parë kontaktuese e kabinetit të KE me të gjitha njesitë punuese tjera,
- Benë interpretimin e planit ditor të kabinetit të KE,

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Letërnjoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj

### II. Pozita: Zyrtar/e Ligjor

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Mbikëqyrë dhe kontrollojnë zbatimin e planeve dhe aktiviteteve operative të përcaktuara nga udhëheqësi .
- Benë përpilimin e kontratave dhe anekse për qiradhënie të hapësirës të objektit, përpilon kontrata dhe anekse për personel.
- Është përgjegjës për ofrimin e ndihmës juridike për ndërmarrjen në përgjithësi në të gjitha nivelet që kërkohen si dhe jep udhëzime në aspektin ligjor për Departamentet e NPLSAGJ.
- Është përgjegjës për monitorimin dhe aplikimin e rregullave dhe akteve ligjore që ndërlihen me NPLSAGJ.
- Si dhe merr pjesë në hartimin, përpilimin, ndryshimin e rregullave, procedurave, të përcaktuara nga NPLSAGJ.
- Kordinon punën me të gjitha organet, shtetërore, Gjykata, agjencione te ndryshme, përmbareuese, vlerësuese dhe zyrtarë tjerë relevant të fushës ligjore.
- Ndihmon në përgatitjet e procedurave dhe akteve tjera nënligjore për NPLSAGJ si dhe përcjell ndryshimet në legjislacion që kanë të bëjnë me NPLSAGJ.
- Është në dispozicion të Departamenteve të NPLSAGJ që emërohet nga divizionit juridik për punët dhe obligimet ligjore që ka departamenti i caktuar.
- Përgaditë raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore për udhëheqësin.

#### Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Udhëheqësi mundet ta ngarkojë me detyra tjera sipas nevojës së NPLSAGJ
- Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund ta zëvendësojë dhe ti kryen detyrat tjera.
- Kryen edhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, si dhe detyrave të ngarkuara nga udhëheqësi.

#### Kualifikimet

- Fakulteti Juridik
- Aftësi kompjuterike .
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 1 vit përvojë pune në lëmin e njëjtë.
- Aftësi të mira komunikuese
- Trajnime profesionale gjatë karrierës

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Lejës së Njoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj

### III. Pozita: Zyrtar/e për Mardhenie me Publikun

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Menaxhon me punët për marrëdhënie me publikun, duke ofruar informacion tek palet e interesit me qëllim të ngritjes se imazhit të Ndërmarrjes përmes dhënies se informacioneve të sakta për udhëtarët dhe operatorët e transportit;
- Së bashku me KE - në krijon strategji mbi informacionin për opinionin publik dhe zhvillimet në Ndërmarrje, me shkrim dhe me gojë ose përmes mediave të ndryshme;
- Menaxhimi i web-faqes dhe rrjeteve sociale
- Kryen edhe punë tjera nga fushë-veprimtaria e vet dhe pune tjera sipas kërkesës së KE.

#### Detyrat dhe obligimet tjera shtesë:

- Është i/e ngarkuar për menaxhimin e Zyrës për marrëdhënie me publikun (ZMP). Në kuadër të kësaj zyre menaxhohen të gjitha informacionet lidhur me mediat informimin fonik dhe vizuel në kuadër të Ndërmarrjes. Në bashkëpunim me KE - në paraqet tek opinionin publik - palët me interes informacione, me qëllim të ngritjes se imazhit të ndërmarrjes.
- Në bashkëpunim me udhëheqësin e shërbimit të transportit përgatit buletin informativ dhe informon lidhur me rendet e udhëtimit të operatorëve transportues.

#### Kualifikimet:

- Njohja e punës me kompjuter (microsoft office).
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi (komunikimi verbal, dhe në të shkruar)
- Aftësi prezantuese, afesi organizative
- Të jetë fleksibil dhe kreativ
- Të ketë aftësi të theksuara komunikative me palët.
- Të ketë aftësi organizative.
- Njohja e gjuheve lokale dhe një gjuhë të huaj, është e preferuar.

#### Dokumentacioni i kërkuar:

- CV-në;
- Diplomë Bachelor në: Gazetari ose komunikim masiv, të Gjuhës Shqipe ose në Shkenca Sociale;
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 1 vjet përvojë pune
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës dhe
- Kopjen e Lejës së Njoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj

### III. Pozita: Kontabilist/e

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore:

- Obligohet që të gjitha dokumentat e pranuar gjatë ditës t'i regjistroi në librin kryesor gjatë ditës paraprake të punës;
- Përgatitë bruto bilancin dhe më së largu deri me 5 të muajit të i'a paraqet shefit të kontabilitetit në shiqim dhe korrekturë eventuale;
- Përgatitë bruto bilancin për përpunimin e llogarisë periodike dhe përfundimtare pas kryerjes së regjistrimit të të gjitha urdhëresave të korrektuara nga llogaritja dhe ndan të ardhurat, në të ardhurat e pastërta dhe mjetet e të ardhurave personale, si dhe urdhëresat lidhur me inventarizimin;
- Personalisht është përgjegjës për barabarësinë dhe identitetin e shënimeve në librin kryesor me shënimet mbi gjendjen e rezervave materiale të riparimeve të mjeteve, mjetet themelore të tjera me të cilat Ndërmarrja disponon (mjetet në xhirrollogari, llogaritja e mjeteve divizore, arka, etj.);
- Përpilon faturat mujore të qirasë dhe shpenzimeve të blerësve-qiraxhinjve;
- Faturimi i qirave të lokaleve gjithnjë sipas kontratës që posedon qiramarrësi dhe për çdo risi të njoftohen llogaridhënësit, si për qera ashtu edhe për shpenzime të krijuara si rryma, uji dhe të tjera;
- Të ndiqen me inkasim qiraxhinjët borxhli pas afatit ligjor prej 15 ditëve;
- Përpilon raporte të vazhdueshme mujore dhe vjetore mbi gjendjen (hyrje-daljen) e çdo qiramarrësi;
- Përgatitë listat e të ardhurave personale mujore dhe mban përgjegjësi për korrektësin e saj;

- Përpilon fletëpagesat dhe paguan detyrimet tatimore fiskale, taksat komunale, kontributet pensionale, tatimet në burim dhe komunalive tjera;
- Kryen pagesa bankare;
- Kryen edhe punët dhe detyra tjera të përcaktuara nga ZFKTH;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet KE dhe ZFKTH

**Kualifikimet:**

- Fakulteti Ekonomik
- Njohja e punës me kompjuter dhe programeve të kontabilitetit
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 1 vjet përvojë pune në lëmin e njëjtë
- Të ketë aftësi të mira analitike.
- Të ketë aftësi organizative.

**Dokumentacioni i kërkuar.**

- CV-në;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional dhe të përvojës së punës
- Kopjen e Lejës së Njoftimit
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj

**V. Pozita: Përcjellës / Dispeqer**

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

**Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Përcjell linjat dhe hyrje daljet e autobusëve;
- Siguron që autobusët të ndalen në peronët e caktuar sipas rendit të udhëtimeve;
- Siguron që autobusët të parkohen në vendin e duhur;
- Kryen edhe punët dhe detyra tjera të përcaktuara nga Shefi Stacionit dhe KE;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Stacionit.

**Kushtet për pjesëmarrje: Kualifikimi dhe Aftësitë:**

- Përgaditje e mesme shkollë;
- 1 (një) vite përvojë pune;
- Të mos jetë nën hetime për vepër penale ;
- Shkathësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike;

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Diploma mbi shkollimin.
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj;

**Informata të përgjithshme:**

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjestarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.

**Mënyra e aplikimit:**

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Konkursi është i hapur nga data 20.02.2023 – 06.03.2023.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

**Vërejtje:** Të cektet qartë titulli i vendit të punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Gjakovë, më 16.02.2023

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Sabina Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftëat e kl. 10.11.12. të Gjimanzit "Hajdar Dushi".

- Mana Pervorfi Novosell e Ulët, shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. "Engjull Jak Gjoni" Novosell e Ulët kk Gjakovë nga kl. I-VIII.

- All Star Sport Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më nr. 811847394.

- Luljeta Qoqaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.

- Ardit Gashi shpall te pavlefshme certifikaten shmlt "11 Marsi" Prizren

- Onda Bilard&Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811348631.

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloshi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"

- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" ( ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjimmnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjminazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




## MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues